



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data:
02 Dhjetor 2020

Nr:
26

VENDIM

PËR VERIFIKIMIN E DEKLARIMEVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË KANDIDATIT ZJ. BENORETA ARBEN LEKAJ NGA LISTA SHUMEMËRORE E PARTISË SOCIAL DEMOKRATE TË SHQIPËRISË, PËR KËSHILLIN E BASHKISË VAU-DEJËS, NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015 “PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE”

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 19, pika 1, germa “n” dhe pika 2 e Ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; neni 11 i ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; Kreu V i Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur;

VËREN

Me shkresën nr. 2362 prot., datë 31.08.2020, këshilli i bashkisë Vau-Dejës ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës, për arsye të dorëheqjes nga mandati i këshilltarit zj. Arlinda Frrok Lazri, propozuar nga subjekti politik Partia Social Demokrate e Shqipërisë.

Referuar nenit 164 të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Social Demokrate të Shqipërisë, për këshillin e bashkisë Vau-Dejës, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 25, zj. Benoreta Arben Lekaj.

Me shkresën nr. 1940 prot., datë 11.11.2020 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në këshillin e bashkisë Vau-Dejës, zj. Benoreta Arben Lekaj, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Referuar nenit 11 të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.



Data: 02 Dhjetor 2020 Nr. 26

Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit zj. Benoreta Arben Lekaj nga lista shumemërore e Partisë Social Demokrate të Shqipërisë, për këshillin e bashkisë Vau-Dejës

Kandidati për këshilltar përcaktuar në bazë të listës shumemërore të subjektit politik Partia Social Demokrate e Shqipërisë, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit me numër 0052 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të kandidatit për anëtar zj. Benoreta Arben Lekaj, në këshillin e bashkisë Vau-Dejës, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe Kreut V, pika 2, germa "b" dhe pika 3, germa "c", të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", me shkresën nr. 2100 prot., datë 24.11.2020 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 2099 prot., datë 24.11.2020 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar zj. Benoreta Arben Lekaj, në Këshillin e Bashkisë Vau-Dejës, që ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës tonë për verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar në këshillin e bashkisë Vau-Dejës, zj. Benoreta Arben Lekaj.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore me shkresën nr. 12019/1 prot., datë 27.11.2020 ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar zj. Benoreta Arben Lekaj, në këshillin e bashkisë Vau Dejës, i cili rezulton me status i padënuar nga gjykatat shqiptare.

Referuar nenit 49 të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" këshilli i bashkisë ka kompetencën për dhënien e mandatit, anëtarit të këshillit bashkiak.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar pikës 2, Kreu V të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstaton se, për kandidatin për anëtar zj. Benoreta Arben Lekaj, në këshillin e bashkisë Vau-Dejës, të dhënat e të cilit nuk përbëjnë kusht për mos zgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit, duhet të vazhdojnë procedurat për dhënie mandati nga këshilli i bashkisë Vau-Dejës.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, germa "n" dhe pika 2 e Ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; nenin 11, i ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; Kreu V i Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".



VENDOSA:

1. Zj. Benoreta Arben Lekaj, kandidat për anëtar në këshillin e bashkisë Vau-Dejës, i subjektit politik Partia Social Demokrate e Shqipërisë, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.
2. Vazhdimin e procedurave nga këshilli i bashkisë Vau-Dejës, për dhënien e mandatit, kandidatit të listës shumëmemërore zj. Benoreta Arben Lekaj, i subjektit politik Partia Social Demokrate e Shqipërisë, për plotësimin e vendit vakant në Këshillin e Bashkisë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative së Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Dirjan CELIBASHI



Nr. 2247 prot.

Tiranë, më 08.12.2020

